

HAJRI SHEHU

**ÇËSHITJE TË GJUHËS SË FOLUR NË MJETET
E INFORMIMIT MASIV**

Kur flasim për gjuhën e folur, kemi parasysh konferencat e shtypit, intervistat, takimet e bisedat politike, fjalimet, tryezat televizive e radiofonike etj., të cilat nuk parapërgatiten. Por, edhe pse e paparapërgatitur, ajo është formë e gjuhës dhe, edhe për arsye jashtëgjuhësore, e normativizuar deri në kufijtë e gjuhës së shkruar, domethënë, edhe në një konferencë shtypi, intervistë, takim politik, tryezë televizive etj. folësi duhet të orientohet nga normat e gjuhës së shkruar. Kjo do të thotë, atëherë, që edhe gjuha e folur nuk mund të jetë e nuk duhet të jetë më pak standarde se gjuha e shkruar. Më së pari, me fjalën dhe zgjedhjen e fjalës. Na duket se tri janë çështjet që mund të shtrohen përkitazi.

1. Reformat e pandërprera politiko-shoqërore pas viteve '90 të shekullit të kaluar e përkëtej, ardhja e teknologjive të reja, zhvillimi shumë i shpejtë i telekomunikacionit dhe i informatikës, rritja e lëvizshmërisë së kapitalit e administrimi i tij, rritja e kulturës e prirja për një mënyrë jetese me botën perëndimore, madje, edhe prirja për të menduar dhe vepruar ndërkombëtarisht, ndikimi i gjuhëve të huaja, sidomos i anglishtes etj. kanë sjellë edhe mjaft prurje në ligjërimin e folur. Dy janë prurjet leksikore kryesore në gjuhën e folur: fjalë të huaja, kryesisht anglicizma dhe kalke.

Siç dihet, specifika e ligjërimin përcaktohet nga forma dhe nga semantika e shtresave leksikore. Edhe forma (fjalë që ndihen si të huaja ose struktura të kalkuara), edhe semantika (më të shumtën, terma ose dysorë) i çojnë këto fjalë të njësi të shenjara stilistikisht si librore. Kjo do të thotë që jo vetëm, thjesht si të huaja¹, ose si kalke por edhe si librore, ato e rëndojnë

¹ Shih, p.sh. *staf e draft, impakt e implementim, efiçensë e bekgraund, shou e emergjencë, kompeticion e prioritet, asistoj e inicioj, lider e lidershhip, risk e resurs, startoj e monitoroj, kolaps e akses, opsion e handicap, suport e suportoj, supervizoj e investigoj, prononcim e kontestim, performoj e performancë, eksit poll e evazion fiskal, në respekt / të ligjit e në akordancë (në akordancë të plotë me faktorin ndërkombëtar)* etj. Jo rrallë, fjalë të huaja të panevojshme dëshmojnë jo vetëm për thënie stereotipe, por edhe për keqkuptime e gabime në shprehjen e mendimeve; shih, p.sh.: pasi u instalua qeveria e re / u instaluan policë rreth ambasadës; muzikë e pasterizuar; policia veproi sipas *inteligjencës*; me *potencial* të madh për aksidente; të *procedojmë* me një politikë të re; *operojnë* jashtë ligjit; ajo që duhet *ekzekutuar* në këtë çast; opozitë *aksidentale*; politikë *aksidentale*; ju keni zgjedhur *aksidentet*; për *promovimin* e grave në zgjedhje; të gjithë vijnë nga jurisprudenca dhe *implementohen* në sektorë që nuk kanë lidhje me jurisprudencën; në këtë *panel* do të jetë *akomoduar* juria jonë / vini

mjetin e informimit masiv dhe vetë ligjërimin e aksh personi në konferencë, në takimin politik, në intervistë etj. Më shumë se kaq: Gjuha është një ndërmarrje bashkëpunimi e ortakërie: teleshikuesi a dëgjuesi është ortak i folësit. Është e vërtetë se ka një shikues a dëgjues, përgjithësisht me nivel jo të vogël kulturor, me një fjalor aktiv e pasiv, gjithashtu, jo të vogël, madje, një pjesë, edhe me njohje gjuhësh të huaja. Por ka edhe një shikues a dëgjues që nuk e ka këtë nivel e kur përdoren sidomos fjalë të huaja të panevojshme, bashkëpunimi e ortakëria prishen, sepse dëmtohet aftësia kumtuese e shprehëse e thënies. Mbase, edhe ata e ato me nivel jo të vogël kulturor nuk do t'i kuptonin të thëna të tilla: *strukturat e bujqësisë do të jenë agresive...; kopje libri të dekoruara me ar; monedhat janë konservuar; Organizata për Konservim (të Gjirokastrës); dosje që janë ekzekutuar; çështja do të ketë një solucion; për indeksin e performancës...; adaptimi i kushtetutës; frustrimet kanë ardhur...; për të vendosur termat e bashkëpunimit; në krye të toplistave; biznemen me lidhje okulte* etj.

Prof. E. Çabej dhe prof. A. Kostallari e kanë vlerësuar shumë qortueshëm këtë dukuri, madje, atëherë kur kalkimi dhe huazimi i panevojshëm nuk ishin në këtë shkallë si sot. E. Çabej shkruan: “Sot ka gjer diku dy gjuhë ndër ne: më një anë, gjuha e shkruar e intelektualëve, në anën tjetër gjuha e thjeshtë e popullit”². A. Kostallari vëren se “po rrudhet relativisht pësha specifike e fjalëve bazë të shqipes, që janë fjalët e burimit popullor dhe po krijohet njëfarë rreziku i largimit të papërligjur të gjuhës letrare kombëtare nga gjuha e folur e popullit”³. A. Kostallari jep rrugën e zgjidhjes së problemit. “Njëra ndër rrugët themelore të zgjidhjes së këtij problemi, - shkruan ai më tej, - është kufizimi i kalkimeve nga gjuhët e huaja (nënvizimi ynë – H.Sh.), sepse pikërisht këto kalkime janë burimi kryesor i përpjesëtimeve jo të përligjura në mes fondit popullor e libror të shqipes së sotme letrare”⁴. Nëse kalket janë të tilla, kur, sidoqoftë në to “do kërkuar jo vetëm struktura e huaj, po edhe impulsi e modeli i shqipes”⁵, atëherë, ç’mund të thuhet për fjalët e huaja të panevojshme (tipi *agravoj*,

re: njerëzit zgjedhin aksidentet, gratë promovohen si librat, instalohen policë, siç instalohen në një ndërtesë pajisjet hidraulike, implementohen njerëzit, siç implemtohet një marrëveshje a premtim, akomodohen njerëz në panel, por akomodimi lidhet edhe me hotele e me fjetje (!) etj.

² Shih: E. Çabej, *Studime gjuhësore*, III, Prishtinë, 1976, f. 101. Shih më gjerë po aty, f. 101, 102.

³ Shih: A. Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, “Studime filologjike”, 4, 1984, f. 44-45.

⁴ Po aty.

⁵ Shih: J. Thomai, *Rreth studimit historik të leksikut të shqipes sipas studimeve të prof. E. Çabejt*, “Studime filologjike”, 3, 1988, f. 84.

alinjoj, *definoj*, *dipendoj*, *prevenoj*, *interferoj*, *involvoj*, *supervizoj*, *overdozë*, *handikap*, *akses*, *indikator* etj.)? Mund të thuhet se ato e rritin diglosinë. Kjo rritje diglosie në gjuhën e folur mund të pasqyrohet edhe në gjuhën e shkruar e më pas, edhe në fjalorë (sidoqë pasqyrimi në fjalorë bëhet sipas kriterëve normative), sepse objekt themelor i fjalorëve është gjuha e shkruar. Përfundimi: shtohet edhe më shumë rreziku i largimit të papërligjур të gjuhës letrare kombëtare nga gjuha e folur e popullit.

2. Terminologjia është, siç dihet një ndër drejtimet themelore të intelektualizmit të gjuhës standarde. Por, pyetjet që mund të shtrohen lidhur me gjuhën e folur të mjeteve të informimit masiv janë: a) A ka kufi ndarës midis terminologjisë dhe gjuhës së zakonshme? b) A mund të ketë diversitet terminologjik në formën e sinonimisë?

a) A ka kufi ndarës? Varet nga realiteti jashtëgjuhësor. Gjuha e folur i çon mjaft terma drejt ligjëritimit bisedor, të përditshëm për arsye të përdorimit të vijueshëm në jetën e në veprimtaritë e përditshme, sidomos në veprimtaritë popullore. Kujtojmë terma të hekurudhës (*shinë*, *kryqësore*), të ndërtimit (*hekurbeton*), të kimisë (*hekszaktorant*), të matematikës (m^2 e m^3), të sportit (*automobilizëm*) etj. Kjo do të thotë që ka terma që i kanë tejkaluar ose që mund t'i tejkalojnë kufijtë e ngushtë dhe kanë hyrë ose mund të hyjnë në përdorim të përgjithshëm, duke u bërë kështu pjesë e shtresës së përgjithshme të gjuhës standarde. Por jo të gjitha e jo gjithçka. Atëherë, çështja shtrohet ndryshe. Natyrisht, televizioni e radioja, si mjete të informimit masiv, kanë edhe emisione me rreze të gjerë, nga të gjitha fushat e jetës, pra, edhe shkencore, teknike, fetare etj. Ndërkaq, shikuesit e dëgjuesit u përkasin grupeve të ndryshme sipas shkollimit, profesionit etj. dhe i duan të tilla emisione. Kjo do të thotë që nuk mund të mos ketë emisione që u përkasin rrethve të tilla shikuesish e dëgjuesish; kjo do të thotë, atëherë që nuk mund të mos intelektualizohet gjuha e emisionit e nuk mund të mos përdoren terma (në parantezë: ata mund të jenë ndërkombëtarizma – *transistor*, *skaner* etj.; neondërkombëtarizma, të cilët, për arsye të ndikimit të anglishtes, ne i marrim nga gjuha angleze – *telefaks*, *teletekst* etj.; ndërkombëtarizma neoklasikë, të cilët, gjithashtu, i marrim nga anglishtja për arsye të ndikimit të saj – *megabait* etj.; huazime të vjetra greke, huazime latine, italiane, angleze etj.), që janë vlera të domosdoshme gjuhësore, që pasqyrojnë zhvillimin e kulturës botërore e që gjuha shqipe i ka bërë të vetat për arsye gjuhësore e jashtëgjuhësore, të tilla, si *buxhet*, *çek*, *blister* (*bakër blister*), *olimpiadë*, *rokenroll* etj. Por ajo që është për t'u qortuar në gjuhën e folur të mjeteve tona të informimit masiv është: Përdoren terma, madje edhe të huaj jo vetëm në tekste *shumë të veçanta* (që gjithsesi, të tilla tekste nuk duhet të zënë vend aty sepse emisionet televizive e radiofonike nuk janë tubime specialistësh e nuk e kanë për detyrë profesionalizimin e punës së tyre), por edhe në tekste me karakter shkencor-

popullarizues (shih, p.sh. si flitet në një emision për drogat: *vetitë psikotrope* (të kanabisit); *produktet e derivuara të kanabisit*; *si kreativ klasifikohet si drogë* etj.) e edhe më keq, edhe në emisione të zakonshme (shih, p.sh. *situata hidrike, mikrobe me origjinë hidrike; një çekap i lëkurës; paketë ndihme e injektuar nga qeveria; qumësht i kontaminuar*, Shqipëria nuk është vend i *intoksikuar*), madje, edhe në reklama (*komforti i dyshekut, konturohet dysheku, kompania lider* etj.).

b) A mund të ketë diversitet terminologjik? Mund të ketë diversitet terminologjik (por jo ambigjeni e pasaktësi) në formën e sinonimisë (edhe pse sinonimia nuk pëlqehet në terminologji) kur përputhen një me një termat sinonimë me konceptet. Sinonimet terminologjike mund të jenë leksema të analizueshme: fjalë a formime popullore (krahaso **rëndesë** dhe *gravitet*, **miush** dhe *maus*, **rrokaqiell** dhe *grataç(i)elë* etj.), por edhe fjalë a formime diturore shqipe (krahaso **kundërpërgjigje** dhe *replikë*, **rrjedhje tatimore** dhe *evazion fiskal* etj.).

Përse mund të ketë sinonimi terminologjike? Pyetjes mund t'i përgjigjemi me pyetje: A është më mirë të mbahet ana e njerëzve të thjeshtë të popullit që ta motivojnë termin e kështu ta kuptojnë atë apo të jepen terma të njohshëm për specialistët, por të panjohshëm për masat, të cilave u drejtohet emisioni a tryeza në televizion a në radio? Me fjalë të tjera, a duhet të mbahet ana e specialistëve e të krijohet kështu ajo diglosia midis gjuhës së zakonshme të njerëzve të thjeshtë dhe gjuhës teknike të specialistëve? Mendimet mund të jenë të ndryshme. Ne mendojmë se sidoqoftë, është detyrë e televizioneve dhe e radiove të ruajnë fort lidhjet me gjuhën e gjallë të popullit (shih edhe një herë formimin popullor *rrokaqiell* – si formimi, gjithashtu, popullor *djegagur*) sepse kjo sjell demokratizimin e mëtejshëm të gjuhës së folur të mjetit të informimit masiv. Trysnia e fuqishme, sidomos në gjuhën e folur, veçanërisht nga gjuha angleze nëpërmjet huazimeve të mirëfillta për arsye që tashmë dihen, përballet e përballohet duke kërkuar fjalë e formime të analizueshme nga ana kuptimore e fjalëformuese.

3. Nismëtar i tryezës televizive, i intervistës etj. është drejtuesi i emisionit, zakonisht, gazetari televiziv ose radiofonik. Ai nuk duhet të jetë më poshtë se i intervistuari, teleshikuesi a dëgjuesi në punë të normës leksikore, fjalëformuese⁶, gramatikore, terminologjike etj. Në njëfarë mënyre, informacioni gjuhësor i drejtuesit të emisionit është si ai i leksikografit. Si leksikografi, edhe ai zgjedh e për zgjedh. Ai ka në dorë fjalën e tij, tekstin e tij dhe kontekstin e tij. Përdorimi i fjalës së tij ka vlera sociale. Mënyra se si flet

⁶ Ai duhet të dijë, p.sh., cila është normë fjalëformuese: *pretendent* apo *pretendues*, *investigativ* apo *investigues*, *komplikativ* apo *komplikues*, *vetëgjyqësi* apo *vetëgjykim* etj.

dikush tregon çfarë është e çfarë dëshiron të jetë – ai dhe dëgjuesi i tij⁷. Dallohet korrektësia nga stili. Korrektësia ka të bëjë me përdorimin aktual të folësve të shkolluar e të kulturuar të gjuhës. Jokorrektësia ka të bëjë me përdorimin e trajtave dialektore, fjalëve të huaja të panevojshme, termave specialë e tepër specialë etj. në një situatë të papërshtatshme a në një kontekst të papërshtatshëm. Drejtuesit të emisionit i duhet korrektësia, sepse nuk e ka vetëm për vete, por edhe për të tjerët. Ai ka detyrën dhe përgjegjësinë për t'u kujdesur për leksikun, për standardizimin, duke parapëlqyer normën leksikore, sidomos për të shmangur atë që është fjalë e huaj e panevojshme⁸, duke parapëlqyer profesionalizmat, por jo termat e ngushtë specialë etj. Vërtet, shqipja është gjuhë e hapur e dinamike dhe ka aftësinë t'i rindërtojë fjalët e huaja për nga fonografia e gramatika (krahaso *implement* dhe *implementoj*, *seléct* dhe *selekt*, *reláx* dhe *relaksoj*, *suppòrt* dhe *suportoj*, *presùme* dhe *prezumoj* etj.), por kjo nuk i jep kurrsesi të drejtë drejtuesit të emisionit të futë pa të keq në kumtimet e tij fjalë të huaja të panevojshme,⁹ sepse është **thyerje** subjektive e **standardit**. Atëherë, një vetëruajtje e vetëdijshme duhet të jetë tipar i gjuhës së drejtuesit të emisionit, sidomos në punë të mospërdorimit të fjalës së huaj të panevojshme.

SUMMARY

ISSUES OF SPOKEN LANGUAGE IN MASS MEDIA CHANNELS

I. The influence of foreign languages, mostly of English over the Albanian broadcasting language, especially since 1990³ is a well-known fact. Two main lexical inputs can be observed: English loanwords and calques. As is known, both of them are stylistically marked as bookish words. This means that they

⁷ Shih, p.sh., anakronizmin gjuhësor të fjalëve krejt bisedore *ashiqare* e *avashllëk* në një bisedë radiofonike: “*Duket ashiqare... që në kontrollin me anë të lekut*” ... “*Ka avashllëk në mbledhjen e ...*”.

⁸ Të tilla si, *afektoj*, *akord* (*akordet e politikës*), *apdejtoj* (*apdejtoj ligjet*), *asistoj* (*asistoj bashkinë*), *dekor* (*për të dekoruar qytetin*), *derivoj* (*problemet që derivojnë*), *diskrecion* (*ruhet diskrecioni i votës*), *fundamental* (*të drejtat fundamentale*), *implant*, *indikator*, *insistencë*, *kauntdaun* (*ka filluar kauntdauni*), *kolumnist*, *kompeticion*, *kompetitiv*, *obligativ* (*masa obligative*), *observacion* (*për të marrë observacione*), *perkusion* (*instrumente të perkusionit*), *prosperues* (*Kosova – shtet prosperues*), *resurs*, *retension*, *survejancë* (*survejanca duhet të jetë e lartë / për gripin e dërrit*) etj.

⁹ Shembujt e përdorur në shkrim janë marrë kryesisht nga televizionet e radiot e Tiranës.

weigh heavily on the broadcasting language. Add to this the fact that there might be viewers or listeners with a low active or passive vocabulary and a low acquaintance of foreign languages. This, of course would result in a break of the cooperation and partnership which should exist between the speaker and the viewer or the listener. This means that it may be considered as a potential risk of an unjustified alienation of the standard language from the spoken language of the people. Solution? Nonuse of the unneeded foreign words and the limitation of the calques.

II. Special terminology is one of the basic direction of the standard language intellectualization. But this intellectualization is under the vigorous pressure, especially from the English language for reasons already known, through direct borrowings or through calques. Of course, radio listeners, TV viewers, the audience in general belong to various groups according to their education, professions, etc. This means there will be broadcasts which belong to a circle of such people, and where one cannot help using special terms and where the language will be the intellectualized. But what is to be criticized is:

a) inappropriate use of loanwords in ordinary scientific-popularizing broadcasts; b) reluctance to search for motivated terms from semantic and wordformation point of view, i.e. analyzable lexemes from native words, native wordformations, etc.; c) indiscriminate use of loanwords on every occasion, with every audience and without the listener or the viewer being considered an equal partner. Solution? There might be terminological diversity (but not ambiguity and inaccuracy) through synonymy (though synonymy is not preferable in terminology), when synonymous terms agree completely the concepts. Terminological synonyms should be analyzable lexemes: Albanian words or Albanian wordformations.

III. Usually, a TV or radio journalist is the initiator and the conductor of a televisual desk, an interview, etc. His linguistic information should be to some extent the same as that of a lexicographer. Like the lexicographer, he should choose and select, for the use of his word bears social values, for he needs correctness and not incorrectness. Incorrectness has to do with the use of dialectical forms of words, unneeded foreign words, highly special terms, etc. in an unsuitable context or situation. Then? Then, a conscious self-protection is required avoiding unneeded foreign words, preferring professional jargon and not narrow special terms.